



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

ADGJTHFR.nr.8/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Kryetari i Gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar më 08.08.2024 nga M.S. nga fshati ... - Komuna Ferizaj, me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtarja Gjykatës Themelore në Ferizaj M.M., në bazë të nenit 3, 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 21.08.2024, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e datës 08.08.2024 parashtruar nga M.S. nga fshati ... - Komuna Ferizaj, kundër M.M., Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me pretendimin për shkelje disiplinore në çështjen civile të evidentuar në gjykatë me numër SMIL si: 2020:139988, për shkak se nuk konstatohet se kemi të bëjmë me ndonjë shkelje disiplinore.

A r s y e t i m i

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj si autoritet kompetent, më 08.08.2024 përmes zyrës së pranimit në gjykatë, ka pranuar kërkesën e paraqitur nga M.S., lidhur me lëndën 2020:139988, për shkak të dyshimit të paanësisë së gjyqtares M.M., duke theksuar se kjo çështje është gjykuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj me aktgjykim të datës 15.05.2027, pas ankesës ishte kthyer në rivendosje nga Gjykata e Apelit me Aktvendim AC.nr. 4766/17, më datë 05.10.2020, dhe që nga ajo kohë gjyqtarja ka mbajtur vetëm një seancë me datë 08.09.2022, që i bie pas dy (2) vite nga aktvendimi i Gjykatës së Apelit, duke konsideruar se ka shkelur nenin 199 të LPK-së. Tutje,

në kërkesë shtoi se kishin kaluar katër vite nga Aktvendimi i Gjykatës së Apelit dhe asnjëherë nuk ka caktuar apo nxjerrë vendim për këtë çështje, ashtu që konsideron se ka shkelur parimet juridike për një proces pa zvarritje dhe në kohë të arsyeshme. Ankuesi, përmes kësaj ankese, kërkoi nga autoriteti kompetent që gjyqtarja M.M. të përjashtohet nga ky rast, apo ndaj saj të iniciohet procedurë disiplinore.

Kryetari i Gjykatës, si autoritet kompetent pas pranimit të ankesës duke u mbështetur në nenin 9 paragrafi 5 i Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Nr. 05/L-057 përmes shkesës ADGJTHFR.nr.8/24 të datës 14.08.2024 ka njoftuar Këshillin Gjyqësorë të Kosovës lidhur me regjistrimin e ankesës së parashtruar nga M.S..

Duke u mbështetur në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kryetari i gjykatës si autoriteti kompetentë po me datë 27 qershor 2024 ka kërkuar deklaratë nga gjyqtarja ndaj të cilit është parashtruar ankesa, e cila në deklaratën e saj datë 13.08.2024, ka përshkruar kronologjinë e veprimeve në këtë çështje ku me datë 08.09.2022 është mbajtur seancë në të cilën janë deklaruar i autorizuar i paditësit, i autorizuari i të paditurës komuna Ferizaj dhe të njëjtën ditë ka marr vendim procedural për vërtetimin e legjitimitetit pasiv të Ministrisë së Infrastrukturës në Prishtinë. Gjyqtarja po ashtu ka theksuar se për shkak të numrit të madh të lëndëve të vjetra të cilat i ka trajtuar dhe për të cilat kanë marrë vendime gjyqtarët tjerë e të cilat lëndë kanë kaluar tek unë si gjyqtare, si dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndëve që janë në gjuhën shqipe dhe të njëjtat duhet të përkthehen në gjuhën serbe, për këtë arsye nuk kam mundur të njëjtën ta trajtoj deri më tani, megjithatë përkundër të gjithave lëndëve që jam e ngarkuar, këtë çështje për seancë gjyqësore do të caktohet në muajin shtator 2024. Prandaj kjo nuk është arsye për fillimin e procedurës disiplinore ndaj meje si gjyqtare.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtares së rastit si dhe shkresave tjera që ka bashkangjitur pala ankuese por edhe shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtares M.M., pasi që duke pasur parasysh rrethanat objektive që kanë ndikuar në punën e gjyqtares, siç janë numrin e madh të lëndëve që gjyqtarja është e ngarkuar, po ashtu rrethanat tjera që lëndët që ka gjyqtarja në punë, shumica e shkresave ka nevojë që të përkthehen në gjuhën serbe, e të cilat rrethana ndikojnë në

procesin e punës së gjyqtares, megjithatë edhe përkundër të gjitha këtyre rrethanave gjyqtarja në deklaratën e saj ka theksuar se kjo çështje është planifikuar që të trajtohet në muajin shtator 2024.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, si dhe bazuar në të dhënat e përshkruara si më lartë Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillim të hetimeve disiplinore.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
ADGJTHFR.nr.8/24, datë 21.08.2024

Mustaf TAHIRI

Kryetar i Gjykatës

Iu dërgohet:

M.S. nga fshati ...- Komuna Ferizaj, Parashtrues i ankesës

M.M., Gjyqtare

Këshillit Gjyqësor të Kosovës